

BLLOKU I SHËNIMEVE PËR

KONFERENCËN E

PËRGJITHSHME

**BËHU
GATI!**

Përpara se të fillojë konferenca,
mund të përgatitesh për ta
dëgjuar zërin e Zotit duke kërkuar
zbulësën tënde vetjake.

- A kam shpenzuar kohë për lutjen vetjake?
- A i kam lexuar shkrimet e shenjta?

“Ju ftoj të mbani vesh për tri gjëra gjatë kësaj konference: të vërtetën e kulluar, doktrinën e kulluar të Krishtit dhe zbulësën e kulluar. . . . Mund t’ju siguroj se ajo që do të dëgjoni sot dhe nesër, përbën të vërtetë të kulluar.”

Presidenti Rasëll M. Nelson¹

PYET

"Zbulesa pothuajse gjithmonë vjen si përgjigje ndaj një pyetjeje."

Plaku Xhefri R. Holland²

dhe më Pas Dëgjo


"Zbulesa e kulluar për pyetjet në zemrën tuaj, do ta bëjë këtë konferencë shpërblyese dhe të paharrueshme. Në qoftë se nuk e keni kërkuar ende shërbesën e Frymës së Shenjtë që t'ju ndihmojë për të dëgjuar atë që Zoti do t'ju vinte të dëgjonit gjatë këtyre dy ditëve, unë ju ftoj ta bëni këtë tani."

Presidenti Rasëll M. Nelson³

Çfarë ke në mendje?

Mendo për pyetjet ose shqetësimet që mund të kesh. Mund t'i shkruash këtu dhe t'i mbash në mendje ndërsa dëgjon konferencën. Edhe nëse nuk ke ndonjë gjë specifike në mendje, Zoti do të të ndihmojë të gjesh mënyra për të mësuar dhe për t'u rritur kur bën përpjekje për ta dëgjuar Atë.

Këtu janë disa shembuj dhe një vend për të shkruar shembujt e tu:



MBAJ SHËNIME!

Tregoji Zotit se je gati të marrësh zbulesë dhe të veprosh sipas saj, duke u përqendruar në dëgjimin e Shpirtit dhe në shënimin e asaj që mendon e ndjen. Mos u shqetëso për të shënuar çdo gjë që thuhet. Gjithmonë mund t'u kthehesh, t'i lexosh ose t'i shikosh këto biseda më vonë.

“Ka një analogji të shkëlqyer [për mbajtjen e shënimeve] në Librin e Mormonit. Janë fletët e mëdha, ku ndodhet historia e popullit dhe fletët e vogla, ku ndodhen zbulesat dhe shkrimet e shenjta. Nëse një person që dëgjon një fjalim . . . po shkruan atë që po thotë personi, atëherë po shkruani në fletët e mëdha – historinë e mbledhjes. Nëse po shkruani mbresa individuale që po ju vijnë nga Fryma e Shenjtë, ju po krijoni fletët tuaja të vogla.”

Plaku Dejvid A. Bednar⁴

Ajo që u Dha Mësim:

Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:

DËGJOJE SHPIRTIN. ÇFARË NDIEN?

“Nëse gjithçka që marrim është ajo që paraqet mësuesi, ne po humbasim atë që ka më shumë rëndësi.”

Plaku Dejvid A. Bednar⁵



Ajo që u Dha Mësim:



**NUK KA MËNYRË TË GABUAR PËR
TË MBAJTUR SHËNIME**

A e ke të vështirë të përqendrohesh?
Përpiqu t'i bësh sa më personale shënimet
e tua. Bëj ndonjë shënim me figura, kaligrafi
artistike ose ilustrime për të të ndihmuar që
të kujtosh histori, citime ose nxitje që kanë
domethënie për ty.



*Ta doni njëri-tjetrin,
ashtu si unë
ju kam
dashur ju.*





Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:



NDALO!

A ke marrë deri tani ndonjë përgjigje për pyetjet e tua? Nëse ke marrë, gjej një çast për të shkruar udhërrëfimin dhe drejtimin që ke marrë.



“Unë premtoj se, kur e dëgjoni zërin e Zotit për ju në mësimet e kësaj konference të përgjithshme dhe më pas veproni sipas atyre nxitjeve, ju do ta ndieni dorën e qiellit mbi ju dhe jeta juaj dhe jeta e njerëzve përreth jush do të bekohen.”

Plaku Nil L. Andersen⁶



"Në këto dy fjalë - 'Dëgjojeni Atë' - Perëndia na jep modelin për sukses, lumturi dhe gëzim në këtë jetë. Ne duhet t'i *dëgjojmë* fjalët e Zotit, t'i *mbajmë vesh* ato dhe t'i *kushtojmë vëmendje* asaj që Ai na ka thënë!"

Presidenti Rasëll M. Nelson⁷



Ajo që u Dha Mësim:



Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:

PO TANI?

Sapo të mbarojë konferenca, është koha që të punosh me gjërat që ke dëgjuar dhe ndier. Këtu janë disa pyetje për t'ia filluar:

- Cila është njëra gjë ku të përqendrohesh teksa shkoj përpara?
- A ka ndonjë gjë në jetën time që ndiej nxitje ta ndryshoj?
- Sipas cilave nxitje të veproj?
- Si e Dëgjova Atë [Jezusin] gjatë konferencës?
- Si mund ta Dëgjoj Atë më mirë në jetën time të përditshme?

A je i/e kënaqur nga mënyra se si u ndërlidhën shënimet e tua të konferencës? A ke shënime me figura apo ilustrime që ia vlejné të publikohen në Instagram? Na i trego ato! Dërgoje me postë elektronike një fotografi të shënimeve te ftsoy@ChurchofJesusChrist.org ose publikoji ato në Instagram dhe etiketoji te faqja @strivetobe!





“Përgjigjet ndaj lutjeve tuaja të veçanta mund të vijnë drejtpërsëdrejti nga një bisedë e caktuar ose nga një frazë e veçantë. . . . Një dëshirë më e zellshme për t’i dëgjuar dhe ndjekur fjalët e këshillës do ta përgatitë udhën për zbulësë vetjake.”

Plaku Diter F. Uhtdorf^a

Shënime

1. Rasëll M. Nelson, “E Vërtetë e Kulluar, Doktrinë e Kulluar dhe Zbulësë e Kulluar”, konferenca e përgjithshme e tetorit 2021 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2021, f. 6).
2. Jeffrey R. Holland, “Cast Not Away Therefore Your Confidence”, *Ensign*, mars 2000, f. 9.
3. Rasëll M. Nelson, “E Vërtetë e Kulluar, Doktrinë e Kulluar dhe Zbulësë e Kulluar”, f. 6–7.
4. David A. Bednar, “Create Your Own Small Plates” (material filmik), ChurchofJesusChrist.org.
5. David A. Bednar, “Create Your Own Small Plates”.
6. Nil L. Andersen, konferenca e përgjithshme e tetorit 2017 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2017, f. 126).
7. Rasëll M. Nelson, “Dëgjojeni Atë”, konferenca e përgjithshme e prillit 2020 (*Ensign* ose *Liahona*, maj 2020, f. 89).
8. Diter F. Uhtdorf, “Konferenca e Përgjithshme – Bekim i Pazakontë”, *Ensign* ose *Liahona*, shtator 2011, f. 4.


© 2022 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved.

LEJA PËR TA RISHYPTUR NË LETËR KËTË BROSHURË JEPET PËR PËRDORIM VETJAK, JO PËR TREGTIL. KJO PËRFESHIN LEJEN QË UDHËHEQËSIT E LAÇJES TË SHYPTIN NË LETËR NJË NUMËR TË VOGËL KOPIJESH PËR ATA TË CILËVE U SHËRBEJNË BRENDA KUADRIT TË THIRRJEVE TË TYRE. BROSHURAT DUHET TË SHYPTEN TË PLOTA. KJO NUK PËRFESHIN LEJEN QË KY MATERIAL TË AFISHOHET NË INTERNET, TË RIPËRDORET OSE TË SHPERNDAHET. ÇDO PËRDORIM SHITESË I KËTJY MATERIALI KËRKON LEJË.

permissions.ChurchofJesusChrist.org

KE NEVOJË PËR MË SHUMË KOPJE?

Shkarkoje dhe shtype në letër këtë bllok shënimesh te conference.ChurchofJesusChrist.org.



KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME